

VENDIM
Nr. 331, datë 28.5.2014

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 50, DATË 5.2.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
“PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË PËR PARANDALIMIN DHE SHLYERJEN E DETYRIMEVE
TË PRAPAMBETURA E TË PLANIT TË VEPRIMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr. 185/2013, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 25 e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe plani i veprimit, bashkëlidhur vendimit nr. 50, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

“25. Para pagesës, drejtori i Përgjithshëm i tatimeve të verifikojë që subjektet kontraktore, të cilat paguhet sipas strategjisë, nuk kanë detyrime tatimore kundrejt administratës tatimore qendrore. Në këto raste, subjekti njoftohet me shkrim që detyrimi i pashlyer të paguhet duke marrë në konsideratë detyrimet tatimore të pashlyera dhe atij t’i jepet mundësia për t’u shprehur. Bëjnë përjashtim nga ky rregull pagesat e detyrimeve të prapambetura për zërat e mëposhtëm:

- vendime gjyqësore;
- shpronësime;
- emergjencat civile;
- shpërblime lindjeje.

2. Ngarkohen njësitë e qeverisjes qendrore për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama